

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi për përqendrim të parashtruar nga shoqëria HAJPROM INVESTMENTS me seli të regjistruar në katin e 2-të në Cradock Heights, Avenija Cradosk nr. 21, Rosebank, Johannesburg 2196, Afrika e Jugut dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Debarliev, Dameski dhe Qeleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 02.03.2022, solli

### AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin HAJPROM INVESTMENTS me seli të regjistruar në katin e 2-të në Cradock Heights, Avenija Cradosk nr. 21, Rosebank, Johannesburg 2196, Afrika e Jugut do të fitojë kontrollin e vetëm mbi Shoqërinë tregti dhe shërbime SCM RETAIL SHPKNJP Shkup me seli në rr. Lublanska nr.4, Shkup - Siti Mall/kati i 3-të, Shkup - Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe mbi Balkan Retail NV me seli në Herengracht nr.500, 1017 SV Amsterdam, Holandë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

### Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 09.02. 2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga HAJPROM INVESTMENTS me seli të regjistruar në katin e 2-të në Cradock Heights, Avenija Cradosk nr. 21, Rosebank, Johannesburg 2196, Afrika e Jugut, ku HAJPROM INVESTMENTS do të fitojë kontrollin e vetëm mbi Shoqërinë tregti dhe shërbime SCM RETAIL SHPKNJP Shkup me seli në rr. Lublanska nr.4, Shkup - Siti Mall/kati i 3-të, Shkup

- Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe mbi Balkan Retail NV me seli në Herengracht nr.500, 1017 SV Amsterdam, Holandë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

**Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

- HAJPROM INVESTMENTS është një REIT (një trust investimi në pasuri të paluajtshme) i cili është i fokusuar në tregtinë me pakicë, që kuoton në bursën e Johaneshburgut me një portofol qendrash me pakicë dominuese në qendrat kryesore ekonomike në Afrikën e Jugut, Evropën Lindore dhe Afrikën Sub-Sahariane (me përjashtim të Afrikës së Jugut). Portofoli i Afrikës së Jugut të HAJPROM INVESTMENTS përfshin qendrën super-rajonale Kanal Valk, qendrat kryesore rajonale Klirrvater, D Glen, Voodlands, KejGejt, Somerset Mall dhe Rousbank Mall dhe qendrën rajonale Hajd Park Korner.

HAJPROM INVESTMENTS ka 60% pjesë në HAJSTED LIMITED, një shoqëri private e kufizuar e regjistruar sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar, me zyrën e saj të regjistruar në C/O Doran & Minehane, 25 Ist Street, Bromli, Angli, BR1 1QE, ndërsa pjesa tjetër 40% e pjesës mbahet nga PDI INVESTMENT HOLDINGS LIMITED, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Mauricuis. HAJPROM INVESTMENTS dhe PDI INVESTMENT HOLDINGS LIMITED kanë kontroll të përbashkët mbi HAJSTED LIMITED.

HAJSTED LIMITED është një SHOQËRI investimi në pasuri të paluajtshme që investon në qendra tregtare rajonale me cilësi të lartë dhe dominuese në të gjithë Evropën kontinentale, me fokus të veçantë në Evropën Juglindore dhe Ballkanin, duke zotëruar 100% të Shoqërive të synuara dhe të shoqërisë DELTA MCG, Mali i Zi, dhe kështu zotëron një pjesë në pesë qendra dominuese të shitjes me pakicë në rajonin e Ballkanit: (a) Delta City në Podgoricë, Mali i Zi; (b) Skopje City Mall në Shkup, Maqedonia e Veriut; (c) D Mall në Sofje, Bullgari; (d) City Centar One Ist dhe (e) City Center One Vest, të dyja në Zagreb, Kroaci.

Në tregun e dhënies me qira të hapësirave për shitje me pakicë në qendrat tregtare në Maqedoninë e Veriut, HAJPROM INVESTMENTS është indirekt i pranishëm përmes kontrollit të përbashkët mbi HAJSTED LIMITED, dhe me këtë indirekt kontrollit të përbashkët të shoqërisë për tregti dhe shërbime SCM RETAIL SHPKNJP Shkup, e cila menaxhon qendrën tregtare Skopje City Mall, në komunën e Karposhit në Shkup. Skopje City Mall ka një sipërfaqe bruto që mund të jepet me qira prej 39,000 m<sup>2</sup>.

HAJPROM INVESTMENTS dhe as HAJSTED LIMITED nuk kanë ndonjë prezencë tjetër të korporatës dhe as nuk janë të pranishme në ndonjë treg tjetër në Maqedoninë e Veriut.

- Shoqëria për tregti dhe shërbime SCM RETAIL SHPKNJP Shkup është e pranishme në tregun e dhënies me qira të hapësirave për shitje me pakicë në qendrat tregtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes pronësisë së saj në Skopje City Mall.

Skopje City Mall është qendra e parë tregtare moderne në Maqedoninë e Veriut me një koncept krejtësisht të ri që ndërthur blerjet, argëtimin dhe shoqërimin. Si një nga qendrat më të mëdha të këtij lloji në rajon, Skopje City Mall po rritet ngadalë në një pikë referimi të re të Shkupit modern.

-Balkan Retail NV, një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Holandës, zotëron 100% të pjesëve në AP RETAIL I EOOD, Bullgari dhe KH RETAIL BV, Holandë, ndërsa KH RETAIL BV, zotëron drejtpërdrejt 100% të pjesëve në KH Holdko BV, Holandë, e cila zotëron pjesë në shumën 100% në Manta doo, Kroaci.

Prandaj, pas blerjes së 100% të pjeësve në Balkan Retail, HAJPROM INVESTMENTS do të marrë në mënyrë indirekte kontrollin e vetëm mbi shoqëritë e varura të Balkan Retail: AP RETAIL I EOOD, Bullgari, KH RETAIL BV, Holandë, KH Holdko BV, Hollandë dhe Manta doo, Kroaci.

Shoqëritë e varuratëe Balkan Retail janë aktive në tregun e dhënies me qira të hapësirave me pakicë në juridiksionet e tyre përkatëse të themelimit, përkatësisht AP RETAIL I EOOD Bulgaria operon D Mall në Sofje, Manta doo, Kroacia operon City Center One Ist dhe (v) City Center One Vest, të dyja në Zagreb Kroaci.

- Balkan Retail nuk është i pranishëm në asnjë treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**